



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 168 prot.

Kamëz, më 14/10/2022

V E N D I M

Nr. 127 Datë 14/10/2022

**PËR NJË NDRYSHIM NË VKB NR 132 DATË 22.12.2021 "PËR
MIRATIMIN E DETAJIMIT TË BUXHETIT PËR VITET 2022, 2023, 2024".**

Këshilli Bashkiak i mbledhur sot me dt. 14.10.2022, në kushte të veçanta si pasojë e masave të ndërmara për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19 pasi mori në shqyrtim Projekt- Vendimin nr. 110 dt 14.10.2022,

Në mbështetje të:

- - Ligji nr. 139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore" neni 34, 40, 41, 54, 55,
- Ligji nr. 9936 dt. 26/06/2008 "Për Menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", i ndryshuar,
- Ligji nr. 10 296 dt. 08.07.2010, "Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin",
- Ligji nr. 68/2017 dt. 27/04/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore"
- Ligji nr. 9920 dt. 19/05/2008 "Për Procedurat Tatimore në RSH" i ndryshuar
- Shkresa e MF nr 23026 dt 22.12.2021 "Dërgohet Njoftim transferi të Pakushtëzuar e përgjithshme dhe Sektoriale për vitin 2022",
- Udhëzimin Nr. 2 datë 06.02.2012 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit"
- Udhëzimin Nr. 27 datë 26.02. 2021 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2022-2024 "
- Udhëzimin Nr. 7 datë 28.02. 2022, per nje ndryshim ne udhezimin nr.23 dt 23.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njërive të vetëqeverisjes vendore "
- Udhëzimin Plotesues Nr. 23 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njërive të vetëqeverisjes vendore "

V E N D O S I

1. Miratimin e ndryshimeve të buxhetit të Bashkisë Kamëz për vitin 2022.
2. Miratimin e ndryshimeve në tabelën e funksionimit dhe investimeve për vitin për vitin 2022.
3. Miratimin e strukture buxhetore për vitin 2022 (për ndryshimet) sipas tabelës bashkelidhur.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut.

NEN KRYETAR I KESHILLIT

ALIDAUTI

